



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.49/2019

Prishtinë, më 16.4.2019

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Saranda Bogujevci, Teuta Haxhiu dhe Veton Berisha.

Munguan: Lirije Kajtazi, Sasha Milosavljeviç, Shemsi Syla dhe Fisnik Ismaili.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Skënder Reçica-MPMS, Mentor Tërshnjaku-MPMS, Driton Ademi-këshilltar i ministrit në MPMS, Drita Vitia-Radio Kosova, Gentiana Kadrija-Kosova Press, Fazli Veliu-RTK, Aid Sekiraça-KDI, Emine Shehu-Ekonomia Online, Albana Hajdari-Kosova post, Kenan Gashi-AVONET, Egzona Hoxhaj-Handikos dhe Emine Jakupi-praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara;
2. Diskutim në komision lidhur me temat: Siguria, shëndeti dhe kushtet e punës në sektorin privat në Kosovë dhe gjendja momentale lidhur me koncept-dokumentin dhe draftligjin gjithëpërfshirës për skemat pensionale.
I ftuar, z. Skënder Reçica, ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se te procesverbali i mbledhjes së mbajtur me dt.4 mars 2019, ka një fjali për ta shtuar, por se kjo do të rregullohet me administratën e komisionit.

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më dt. 4 mars 2019, miratohet me plotësimet e deputetes Mexhide Mjaku-Topalli, ndërsa procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më dt.15 dhe 26 mars 2019, u miratuan pa vërejtje.

2. Diskutim në komision lidhur me temat: Siguria, shëndeti dhe kushtet e punës në sektorin privat në Kosovë dhe gjendja momentale lidhur me koncept-dokumentin dhe draftligjin gjithëpërfshirës për skemat pensionale. I ftuar, z. Skënder Reçica, ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale

Kryetarja, tha se kemi të ftuar Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me këto dy tema të cilat janë aktuale dhe tema që e rëndojnë shoqërinë tonë.

Skender Reçica, tha se këto tema, përveç se janë me rëndësi për shoqërinë tonë, janë me rëndësi edhe për ministrinë që ai drejton. Në vazhdim, tha se të gjitha këto po i trajtojnë me kujdes të veçantë, lidhur me sigurinë e punëtorëve në vendin e punës dhe po punojnë përherë e me shumë që të drejtat e tyre që garantohen me ligj, të jenë realitet për ta. Ai tha se përpos masave ligjore që janë ndërmarrë për sigurinë dhe shëndetin në punë, është punuar edhe lidhur me zbatimin e legjislacionit në fuqi. Njoftoi se gjatë periudhës janar-dhjetor 2018, Inspektorati i punës ka realizuar rreth dhjetë mijë inspektime në terren, gjatë këtij viti janë realizuar 2025 inspektime, përveç inspektimeve kemi realizuar edhe disa fushata për sigurinë dhe shëndetin në punë. Ai tha se shihet që kompanitë po ndërmarrin masa mbrojtëse për punëtorët dhe situata është më e mirë se më parë.

Në Kosovë operojnë mbi 60 mijë biznese dhe me kapacitete ekzistuese, thuajse është e pamundur të kemi një inspektim më të shpeshtë. Po ashtu, theksoi se Ligji për Inspektoratin e punës, është në shqyrtim në Kuvend dhe realisht fuqizon rolin e inspektoratit dhe krijon kushte më të mira që të ushtrohet edhe një kontroll ndaj vetë institucionit.

Në të ardhmen do të jemi të pakompromis ndaj atyre që nuk i zbatojnë të drejtat e punëtorëve për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në punë dhe jemi në fazën e shtimit të inspektorëve në punë. Këtë vit do të kemi 20 inspektorë të rinj.

Kryetarja, në vazhdim, pyeti: Sa inspektorë i kemi në terren dhe a janë masat minimale të mjaftueshme për ta mbrojtur një punëtor në terren?

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se muajt e parë të këtij viti nuk përfunduan mirë. Kemi dy punëtorë, të cilët kanë humbur jetën në vendin e tyre të punës. A është i mjaftueshëm ky numër i inspektorëve në terren dhe cilat janë format e inspektimit që ata po i bëjnë? Është mirë që po

sigurohet një fond për sigurinë familjare, çka po ndërmerrni lidhur me familjet, anëtari i së cilës po pëson fatalitet, si e keni menduar krijimin e këtij fondi?

Më tutje, tha se është potencuar se është bërë një plan i punës për inspektimin e bizneseve dhe u interesua të dijë se cilët sektorë të bizneseve i keni me prioritet.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se në qoftë se MPMS nuk e ka ndonjë plan veprimi për trajtimin dhe punësimin e të rinjve, atëherë si mund të përgjigjet një punëtor se po i shkelen të drejtat e punës, në vendin e punës, kur e di që do të largohet nga vendi i punës. Nëse ata kanë kontratë, çka mund të bëjmë ne për ta? Pyeti ministrin: Çka është ndërmarrë për trajtimin e papunësisë, në mënyrë që ta eliminojmë këtë problemin e dukurive që po na ndodhin, qoftë për diskriminim në vendin e punës, por edhe nga aspekti i barazisë gjinore?

Teuta Haxhiu, tha se do të ishte mirë të rishikohet edhe aspekti i dënimit apo gjobës për ndërmarrjet që nuk i respektojnë rregullat e kushteve dhe sigurisë në punë.

Më pas, ajo pyeti: Kur do ta kemi një pasqyrë reale për secilin biznes, qoftë edhe në fushën e ndërtimitarisë, rreth të gjitha çështjeve, si dhe dënimeve që u janë shqiptuar, në mënyrë që në të ardhmen të përmirësohemi?

Veton Berisha, u interesua të dijë nëse u është dhënë mundësia sindikatave dhe OJQ-ve, që të ndihmojnë në procesin e identifikimit të rasteve të shkeljeve të drejtave të punëtorëve.

Saranda Bogujevci, pyeti ministrin: A është bërë ndonjë raport që të dihet se sa duhet të jetë numri i inspektorëve në vend, çka ndodh kur lëndohen punëtorët në vendin e punës në sektorin privat? Në shumicën e rasteve nuk marrin ndihmë dhe mbesin në mëshirën e familjes. Sa i përket skemave pensionale, tha se është mirë të mendohet që personave me aftësi të kufizuara t'iu sigurohet punë dhe t'iu krijohen kushte për punë që mos të mbesin në skema pensionale.

Mirjeta Kalludra, tha se po ndërlidhet me parafolësen, sa i përket personave me aftësi të kufizuara, se a po respektohet ligji i punës, lidhur me dispozitën për personat me aftësi të kufizuara. Ajo tha se është mirë që ka ardhur një ligj i ri i punës në Kuvend, por nuk pash se ky projektligj përmban implikime buxhetore dhe si do të arrihet zbatimi i një ligji, kur nuk parashihet kostoja financiare. Ajo tha se është mirë të njihet puna vullnetare apo praktike, sepse ndikon edhe në luftimin e punësimit joformal.

Ministri Skënder Reçica, në vazhdim, u përgjigj në pyetjet e parashtruara nga deputetët. Ai tha se kemi një grup prej 47 inspektorësh, të cilët jo të gjithë dalin në terren. Kemi një plan të punës për inspektim dhe në bazë të atij plani, inspektorët dalin në terren, vizitojnë bizneset, të cilat i kanë targetuar në bazë të sektorit. Shpesh ndodh që në vizita shkohet në bazë të ankesave, ndërsa theksoi se masat minimale janë ato që e sigurojnë jetën e një punonjësi, siç janë, rrethojat, helmetat, lidhëset, etj., që janë masa të përcaktuara edhe nga ILO. Deri tani nuk ka qenë e rregulluar sesi të trajtohen ato familje, anëtari i së cilës ka pësuar fatalitet e që do të rregullohet me sigurimin e fondeve sociale. Sa i përket identifikimit të problemeve, tha se po përpiqemi përmes vetëdijesimit të raportohen në ministri shkeljet e të drejtave të punëtorëve dhe për këtë vetëm vetëdijesimi mund të kryejë punë në kuptimin afatgjatë. Bashkëpunimi me

sindikatat është i shkëlqyeshëm. Sipas standardeve ndërkombëtare, numri i inspektorëve mendohet të jetë një inspektor në 2000-10000 punëtorë.

Ai sqaroi se ligji i punës nuk ka kosto, ligji i lehonave është në procedurë dhe aty parashihet të ketë kosto, ndërsa me ligjin e ri të punës, tha se praktika do t'u njihet si përvojë pune dhe është e paraparë deri në dy vite dhe kjo u njihet vetëm pas diplomimit.

Mexhide Mjaku-Topalli, pyeti: kujt i raporton inspektorati për punën që e ka bërë në terren, dhe a keni ndonjë raport të përgjigjeve nga ankesat? Nëse nuk e keni tani këtë përgjigje, ju lutem të na i dërgoni.

Skënder Reçica, tha se kemi përgjegjësi për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve dhe të bizneseve, luftimin e punës joformale e kemi prioritet këtë vit. Në vazhdim, ai tha se te Ligji i inspektoratit, shkalla e dytë e ankesave nuk duhet të lihet në inspektorat, por duhet të bartet në ministri, sa i përket punësimit të personave me aftësi të kufizuara, theksoi se ligji nuk është duke u zbatuar në tërësi.

Sa i përket draft-konceptit për Projektligjin për krijimin e kodit pensional, është krijuar një komision ad-hok në Kuvendin e Kosovës dhe neve na është lënë puna në gjysmë dhe kjo është gabim. Gjithë punën që e kemi bërë si ministri dhe me koordinim të plotë me institucionet ndërkombëtare, në konsulta me FMN-në, Bankën Botërore, ekspertë të BE-së dhe e kemi proceduar në Qeveri një koncept-dokument, nga i cili do të dalin dy ligje, ligji unik për pensionet dhe Ligji për fondin e sigurimit social. Në momentin kur ne filluam diskutimin për ta kaluar në Qeveri, lindi kërkesa që Kuvendi duhet ta krijojë një komision për krijimin e kodit unik për pensione dhe tashmë ne si ministri nuk e kemi në agjendë legjislative, sepse tani është në agjendën legjislative të Kuvendit. Ne e kemi pasur në agjendë që në qershor të dy ligjet të vijin në Kuvend dhe i bëj ftesë atij komisioni ad-hok, që mos t'i shmanget atij dokumenti.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se është e shqetësuar me atë se gjithë ajo punë që është bërë nga ministria në hartimin e draft-konceptit për një ligj gjithëpërfshirës për pensionet, tani ka kaluar në një komision ad-hok në Kuvend. Ajo pyeti: Çka mund të bëjmë tani në këtë situatë, a mundemi që në rezolutën që është ende pa votuar, t'i vendosim edhe tri çështje, pensionet kontributpagues, moslajmërimi i pensionistëve dhe nga MPMS, a mund të nxirret një udhëzim administrativ për t'ua mundësuar familjarëve të dëshmorëve të gëzojnë të drejtën e pensionit kontributdhënës dhe në të njëjtën kohë edhe të pensionit të familjes së kategorive të dala nga lufta?

Skender Reçica, me Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, ka plot nene që janë diskriminuese për qytetarët tanë. Kriteri lajmërimit çdo 6 muaj, është kriter ligjor. Në vitin 2017, ka nisur reformën ligjore dhe ka hequr nenin 8 të ligjit, kriteret e lajmërimit. Kemi kërkuar të bëhen lehtësira për pensionet e dyfishta. E dimë që ka pasur kosto buxhetore dhe pikërisht MEF nuk ka lejuar të kalohet në Qeveri. Po ashtu, tha se është një udhëzim administrativ që ka një bazë ligjore që është shqetësuese, por e vetmja gjë ku mundemi më shpejt të bëjmë zgjidhje, për çka edhe kam kërkesën të deponuar më 30 nëntor 2017, në Qeveri, do të shikoj mundësinë që atë iniciativë të 2017, ta procedoj me procedurë të shpejt, që të bëhen këto plotësimet emergjente të Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Teuta Haxhiu, ju si ministri dhe komisioni ad-hok, që është votuar në Kuvend, a keni ndonjë afat apo në bashkëpunim me ministrinë që ju drejtoni, të iniciojmë procedurat për finalizimin e çështjeve që kanë ngucur, pas formimit të komisionit ad- hok?

Skënder Reçica, tha se është takuar me anëtarët e komisionit ad-hok dhe të njëjtat çështje që u thanë këtu, ua ka thënë edhe atyre, sepse ka qenë mëkat që Kuvendi ka ndërhyrë në agjendën e Qeverisë, kur është marrë koncept-dokumenti dhe është futur në ombrellën e Kuvendit. Sikur të ishte në Qeveri, të dy ligjet, në qershor, do të procedoheshin në muajin qershor të këtij viti për shqyrtim në Kuvend.

Saranda Bogujvci, pyeti: Lidhur me lajmërimin e pensionisteve, a është menduar të krijohet një program ndërlidhës me institucionet fetare dhe që hyn në sistem integrues?

Skënder Reçica, tha se nuk është problem lajmërimi, kemi bashkëpunim me komunitat, me institucionet fetare etj., kemi problem vetëm në pjesën veriore të vendit, sa i përket kësaj çështjeje.

3. Të ndryshme

Mexhide Mjaku-Topalli, njoftoi komisionin lidhur me punën që po bën grupi punues për nismën ligjore për Projektligjin e ri për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe tha se pas disa ndryshimeve që janë bërë, në marrëveshje ndërmjet anëtarëve të të njëjtit grup parlamentar, u vendos të bëhen zëvendësime të anëtarëve të grupit punues.

Mexhide Mjaku- Topalli, konstatoi se në grupin punues të lartpërmendur, Shemsi Sylja zëvendësohet me deputeten Saranda Bogujevci, ndërsa deputeten Duda Balje e zëvendëson deputeti Veton Berisha.

Mexhide Mjaku- Topalli, po ashtu, tha se lidhur me kërkesën që e kemi ndërmarrë që burgu i Prishtinës të shndërrohet në muze, kam propozuar të shkojmë t'i vizitojmë institucionet dhe të shohim çka kanë ndërmarrë, të shkojmë te Ministri i Drejtësisë apo ta ftojme në komision, sepse nuk kemi përgjigje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda BALJE